

DEKRET
Nr. 11454, datë 11.3.2020

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 136, paragrafi 2, i Kushtetutës, nenit 49, pika 11, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 5.3.2020, të propozimit të arsyetuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcjellë me shkresën me nr. prot. 1605, datë 5.3.2020 dhe vendimit nr. 112, datë 27.2.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. Ilir Panda”, nga radhët e juristëve të spikatur, shoqëruar me praktikën dokumentuese të kualifikimit, vlerësimit e pikëzimit përfudimtar, dhe renditjes, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 110, datë 9.7.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti **Ilir Panda** emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta